**Perse eshte nje Visite speciale diagnostike per syte ("Screening") si dhe trajtimi i semundjeve te syve tek femijet e vegjel qe jane ne kopshte e ne çerdhe shume e rende-sishme?**

Siç dihet syri - organi i te parit - zhvillohet e rritet gradualisht edhe pas lindjes deri nga mosha 4-6 vjecare - mosha e kopshtit. Demtohet ky zhvillim deri ne kete moshe, mbetet ky nje demtim i pa riparuar me per shikimin per gjithe jeten!

Shume nga keto çrregullime ne zhvillimin e syrit qe konstatohen nepermjet ketij kontolli diagnos-tik te quajtur "screenin" , po qe se arrijne te tra-jtohen sa me shpejt gjate femijerise, jane te rikthyeshme dmth. te sherueshme. Ketu hyne femijet qe konstatohen qe jane driteshkurter ose dritegjate dhe kane Astigmatismus si dhe kryesisht femijet qe u iken njeri sy anash dmth qe kane stabizem. Keta te fundit-femijet me sta-bizem eshte veshtire te diagnostikohen sepse tek shume femije eshte e fshehur semundja dhe e çon femijen ne uljen e shikimit e disa here pothuajse ne humbjen e plote te tij me syrin e prekur po nuk u trajtua sa me shpejt!

Ata qe jane driteshkurtet ose dritegjatet si dhe ata qe kane Astigmatisem korrigjohen duke mbajtur syzet ndersa ata me stabizem duke mbyllur per ca kohe syrin e mire ne menyre qe tu aktivizohet shikimi tek syri i prekur, ne menyre qe ti kthehet shikimi pas ketij trajtimi sa me shume qe te jete e mundur. Ne qoftese nuk tra-jtohet sa me shpejt dmth. sa me heret deri ne moshen e kopshtit me vone nuk ka me mundesi qe te aktivizohen qelizat e te parit, te cilat e nba-rojne fazen e pjekurise pas kesaj moshe, gje qe con deri ne humbjen e plote te shikimit per gjithe jeten me ate sy.

Sidomos para moshes 4 (kater) vjeçare duhen diag-nostikuar femijet nepermjet kesaj vizite thelbesore per syrin e cila ne mjekesi quhet "screening" sidomos kur dihet qe femijet deri ne kete moshe jo vetem nuk ankohen sepse nuk mund ta perceptojne nga vetja qe syri shikon keq por skane se si ta dine qe mund te shikojme edhe me mire me ate sy.

Ulja ose me mire te themi humbja e shikimit tek femijet vjen edhe nga semundje te tjera te syrit si pershembull nga turbullimi i lentes ose siç i thuhet ne mjeksi nga katarakti i lindur ose i zhvilluar gjate moshes se femijerise.

Te gjitha keto raste eshte e mundur vetem neperm-jet kesaj Visite speziale tashme e quajtur "screening" te kapen dmth. te diagnostikohen ne menyre qe te trajtohen sa me shpejt dhe ne kohen e duhur nga mjeku ophtalmolog i syve.

Kontakt:
Dr. Dietrich Kratsch ( Kryetari)
Elfriede Joos-Kratsch ( Referendante)
Tel: 0049/(0) 7071-34633
Email: vorsitz@daika.de
www.daika.de

**Pse kemi zgjedhur shqiperine per ta ndihmuar ne kete drejtim?**

- Shqiperia eshte nje nga vendet me te varfra te europes
- Shqiperia ka perqindjen me te larte te popullsise me femije deri ne moshen 14 vjecare (22% ne krahasim me gjermani-ne qe ka vetem 13,3%)
- vendi me me shume popullesi fshatare ( 46,6% ne krahasim me gjermanine qe ka vetem26%)
- gjate kohes se luftes zivile ne 1997 gati 1/3 e mjekeve shqipetare iken nga Shqiperia si dhe numri i qendrave mjekesore ra 40%
- Shqiperia eshte shume afer gjermanise ti themi komshi duke menduar qe nga Munihu vetem 100 min. me avion na ndajne.
- Shqiperia nuk ka nje Konzept per para-ndalimin dmth Trajtimin mjeksor te femijeve ne keto raste

"Shqiperia eshte akoma edhe sot e mbyllur dhe jo adekuate dmth. e kohes persa i perket kujdesit te shendetit"

Ne ndihmoje me kete Projekt:

*„Gjithashtu, duke qenë se mungon një kulturë e përgjithshme për kontrollin periodik të shëndetit të syve të fëmijëve, realizimi i këtij depistimi nëpër shkollat dhe kopshtet e qytetit të Vlorës do të ishte i mirëpritur dhe gjen mbështetjen tonë*

Shpetim Gjika Kryetar te Vlorës,
Shqiperi

VISION 2020
THE RIGHT TO SIGHT

***Ne jemi nje shoqate bamirese me keto Detyra:***

- *Te japim ndihme e te perkrahim me çdo kusht ne Visitat speciale diagnostike (Screening) per syte tek femijet e kopshteve e deri ne shkollat fillore*
- *Te japim ndihme e te perkrahim me çdo kusht ne visitat ophtalmologjike tek njerezit me shikim te dobet ne pergjithesi*
- *Specializime pre- dhe pasuniversitare te personalit mjeksor dhe te mesem*
- *ndihme per pajisje me veglat e duhura mjekesore okulistike si dhe aparatura per te ndihmuar te parit tek personat qe nuk shikojne ose shikojne shume keq.*

*Ky Projekt do realizohet ne bashkepunim me institucionet mjekesore shqiptare sowie te personalit mjeksor dhe te mesem ne vend.*

*Me kenaqesi mirepresim mjeke oculiste dhe infermjere te kualifikuar si dhe persona te tjere, te cilet me pjesemarrjen e tyre aktive te na ndihmojne dhe perkrahin qe te arrijme rezultatet e duhura!*

# Deutsch-Albanische Initiative KinderAugen DAIKA e.V

DAIKA e.V.

